

Aneksi A i aktit nr. 6461 te koleksionit

STATUTI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

“EDIL COSTRUZIONI S.R.L.”

Neni 1. – Emertimi

Eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nen emertimin e

“EDIL COSTRUZIONI S.R.L.”

Neni 2. – Selia

Shoqeria ka seline ne Komunen Sedico.

Organi administrativ mund te ngreje ose shfuqizoje gjithkund njesi lokale operative si filiale, depozita, agjenci dhe zyra administrative, dhe te tranferoje seline e shoqerise ne hapesiren e Komunes se treguar.

U takon ortakeve te mbledhur ne asamble, me mazhorance te parashikuar per ndryshimet statutore, te vendosi ngritjen e selive dytesore dhe te transferoje seline e shoqerise ne nje Komune tjeter.

Neni 3. – Objekti

Shoqeria ka per objekt:

- 1) Blerjen, realizimin, mirembajtjen, projektimin, ristrukturimin, administrimin dhe shitjen e pasurive te paluajtshme ne pergjithesi dhe ne veçanti kryerje punimesh ne ndertim banesash dhe jo, rrugore dhe pyjore, hidrike, hidraulike, te trajtimit kunder ndotjes, impiante portuale dhe aeroportuale, impiante ne pergjithesi, tubacione uji, drita dhe gaz, ujesjellesa dhe kanale te ujerave te zeza, punime toke, prishjen dhe rindertimin te veprave te ndertimit, çemento armato, ndertim dhe ristrukturim i veprave monumentale, konsolidimin dhe bonifikimin e tokave, impiante sportive, punime ndertimi ne hekurudha dhe te specializuara ne pergjithesi, te impianteve te prodhimit, transport, administrim dhe shitje te energjise dhe te ngrohjes te prodhuar nga trajtimi dhe perpunimi i mbetjeve, si per entet publike (edhe ushtarake) si dhe private dhe gjithë sa eshte e aneksuar dhe e lidhur me ndertimin ne pergjithesi dhe per sa me siper eshte specifikuar;
- 2) Blerjen, administrimin dhe shitjen e pasurive te paluajtshme dhe te drejtave te pasurive te paluajtshme ne pergjithesi;
- 3) Perdorimin e burimeve te energjise dhe administrimin e impianteve te prodhimit te lidhur me te;





- 4) Projektimin dhe elaborimin e operacioneve planimetrike ne pergjithesi;
- 5) Organizimin, koordinimin, administrimin dhe ne pergjithesi te gjithe kontabilitetin e kantierëve – edhe ne cilesine e depozituesit te shkresave kontabel – per llogari te ndermarrjeve qe do kene objekt te ngjashem ose te lidhur me te tuajin;
- 6) Azhornimin, eleborimin dhe printimin e kontabilitetit administrativ – edhe ne cilesine e depozituesit te shkresave kontabel – per llogari te ndermarrjeve qe do te kene objekt te ngjashem ose te lidhur me te tuajin;
- 7) Realizimin, blerjen dhe shitjen si me shumice dhe pakice te lendeve te para, gjysem te perpunuara dhe te prodhimeve me qellim per ndertim ne fushen elektrike, elektronike, mekanike, te materialeve te rezultatit, te materialeve te ndertimit, te zhavorit dhe te reres, te konglomerateve bituminoze, çimentoje dhe te anekseve per punimet perfundimtare dhe perfundimit;
- 8) Blerjen, mirembajtjen, dhenien me qera dhe shitjen si me shumice e me pakice te veglave, makinerive e çdo tjeter te lidhur me sektorin e ndertimit, elektrikut, elektronikes, hidraulike e mekanike;
- 9) Punime kopshtarie, kositje lendinash, sistemime te mjedisit, pastrim te bores dhe transport per llogari te tuajen dhe te treteve, perfshire transportin publik dhe privat te personave;
- 10) Realizimin e sherbimeve te konsulences te projektimit dhe te realizimit e te restaurimit te punimeve te ndertimit (civile, ushtarake dhe industriale), te konsolidimit, rrugeve, autostradave dhe hekurudhave, te inxhinjerise natyrore, te mbrojtjes dhe te ruajtjes te tokes dhe nentokes, administrimin total te ndermarrjeve, kantierëve dhe kontabilitetit. Ajo do te mund te marre persiper prefaqesi tregtare, projektme industriale dhe te kryeje te gjitha operacionet financiare, te pasurive te luajtshme, te pasurive te paluajtshme, bankare dhe siguracioneve te lidhura ose ne teresine e objektit te shoqerise. Ajo do te mund te administroje llogari rrjedhese bankare, edhe te zbuluara, duke leshuar garancite e nevojshme edhe te karakterit hipotekor, garanci qe do te mund te jape enteve ose ndermarrjeve ose shoqerive te lidhura, te kontrolluara ose, sidoqofte, pjesemarrrese ose te interesuara per administrimin e shoqerise. Ajo do te mund gjithashtu te jape dhe te marre per siper pjesemarrje ne ente dhe shoqeri te çdo lloji qe do te kene objekt te ngjashem ose te lidhur me te tuajin. Mund edhe te kryeje çdo operacion tregtar edhe te importit dhe esporti, sa per vehte dhe per komisionet, te derguar ose tranzit, duke kuruar gjithashtu marrjen persiper te depozitave, te konçesioneve dhe prokurimeve, perfaqesi dhe agjensi tregtare sa italiane dhe te huaja, dhe çdo veprim te pasurive te luajtshme, te pasurive te paluajtshme, industriale dhe financiare qe e ben te dobishme dhe te mundshme arritjen e objektit te shoqerise, perfshire dhe transportin e mallrave si per llogari te vet si dhe per te tretet, kontraktoje kredimarrje, finacime dhe kreditim te hapur me ose pa garanci reale, te jape hipoteka dhe pengje, te jape perkrahje, garanci e depozite te hollash si garanci ne pergjithesi edhe ne favor te te treteve, te bleje dhe te shese





ndermarrje ose dege ndermarrjesh, t'i jape ose t'i marre me qera, me ble pjesmarrje me qellimin e vetem te investimit te qendrueshem dhe jo vendosje mbi treg e pra ne rruge ndihmese dhe jo kryesore, pjesemarrje ne shoqeri te tjera, konsorciume dhe bashkësi ndermarrjesh qe do te kene objekt te njejte ose te ndryshem nese eshte i ngjashem, me qellim ose i lidhur me te vehtin, duke mundur qe te shtrije aktivitetin e vet ne sektoret anesor. Aktivitetet e nevojshme dhe te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise do duhet te zhvillohen ne kufijte dhe ne respekt te normave qe disiplinojne aktivitetin, dhe ne respekt te normave qe perbejne ligjet e veçanta, ne veçanti ne temen e aktiviteteve financiare, ose te aktiviteteve te rezervuara te regjistruarve ne Kolegje, Urdhra ose Regjistra profesional.”.

Neni 4. – Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e percaktuar deri me 31 (tridhjetë e nje) dhjetor 2030 (dymijë e tridhjetë) dhe mund te shtyhet ose te shkurtohet me vendim te ortakeve te mbledhur ne asamble me mazhorance te parashikura per ndryshimet statutore.

Neni 5 – Libri i ortakeve dhe vendqendrimi i ortakeve.

Shoqeria duhet te ngreje librin e ortakeve, te mbahet nen kujdesin e organit administrativ sipas dispozitave te percaktuara per shoqerite aksionere, aq sa te perputhshme.

Ne shmangie te neneve 2470 paragrafi 1 dhe 2479 – bis paragrafi 1, te Kodit Civil, transferimi i kuotave te shoqerise dhe themelimi i te drejtave reale mbi ta, si me akt ndermjet te gjalleve si dhe me trashegimi per shkak te vdekje, kane pasoja ndaj shoqerise nga momenti i regjistrimit ne librin e ortakeve, qe organi administrativ eshte i detyruar te kryeje sa me shpejt te jete e mundur nga momenti i depozitimit ne regjistrin e Biznesit i kryer ne baze te ligjit.

Jane te bera perveç parashikimeve te neneve 2470, paragrafi 3, 2471 paragrafi 1 te kodit civil, dhe te dispozitave te tjera te pa shmangshme te ligjit.

Vendqendrimi i ortakeve, per gjithë sa ka te beje mardhenia e tyre me shoqerine, dhe te gjitha efektet e ligjit te treguar ne librin e ortakeve. Per kete qellim ortaket mund t'i komunikojne organit administrativ adresen e tyre te postes elektronike dhe adresen e tyre te telefax. Organi administrativ duhet te azhornoje ne kohe librin e siper cituar me treguesit e komunikuar atyre nga ortaket me menyren e pershtatshme qe te sigurohen me prova marrja eshte arritur., dhe ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga ligji. Ndryshimi i vendqendrimin te ortakeve prodhon efekte, ndaj shoqerise, nga momenti i regjistrimit ne librin e ortakeve.



Neni 6 – Kapitali i shoqerise.

Kapitali i shoqerise eshte 49.920,00 euro (katerdhjeteentemije e nenteqindenezet) i ndare ne kuota sipas ligjit.

Ai mund te jete i themeluar nga te gjithë elementet te aktiveve te mundshem te vleresimit ekonomik.

Neni 7 – ndryshimet e kapitalit te shoqerise.

Kapitali I shoqerise mund te rritet nje ose me shume here ne perputhje me dispozitat e thena nga nenet 2481, 2481 bis e 2481 ter te kodit civil.

Vendimi relative duhet te jete I marre nga ortaket te mbledhur ne asamble sipas paragrafit te trete te nenit 2479 bis te Kodit Civil dhe duhet te rezultojë tek process verbali I hartuar nga noteri.

Rritja e kapitalit mund te jete nepermjet dhenieve te ndryshme nga parate dhe u takon ortakeve te nenshkruajne ne proporcion me kuotat qe secili posedon.

Asambleja mund edhe te vendosi rritjen e kapitalit nepermjet ofertave te kuotave te reja te emetuara nga te tretet fakt i cili perveç se drejtes se doreheqjes nga ortaku disident.

Kapitali I shoqerise mund te zvogelohet ne rastet dhe me modalitetet te parashikuara nga nenet 2482, 2482 bis, 2482 ter, 2482 kuater te kodit civil me vendim te marre nga ortaket te mbledhur ne asamble dhe te adoptohet me mazhorancen e parashikuar per ndryshimin e akteve te aktit te themelimit.

Neni 8 – Emetimin e letrave me vlere.

Me vendim te zakonshem te asamblese te marre me vota favorizuese nga shume ortake qe perfaqesojne mazhorancen e kapitalit te shoqerise dhe nen kujdesin e organit administrativ, mund te emetohen letra me vlere.

Po vete asambleja percakton kushtet dhe karakteristikat e borghi, me mbikeqyrjen per sa eshte percaktuar ne nenin 2483 te kodit civil.

Neni 9 – Derdhje dhe financime te ortakeve.

Ortaket mund te kryejne per nevoja te shoqerise, mbi kerkesen e organit administrativ dhe ne perputhje te dispozitave ligjore, derdhje ne llogarine e kapitalit ose financime si te frytshme dhe jo te frytshme qe nuk perbejne permblendhje te kursimeve ndermjet publikut ne kuptim te normativave ne fuqi ne fushen bankare dhe te kredise.

Derdhjet ne llogari te kapitalit mund te perdoren per mbulimin e humbjeve te mundshme ose per rritjen e kapitalit te shoqerise ne baze te vendimit te ortakeve te mbledhur ne asamble.



Financimet e ortakeve, nese jane te kryera ne proporcion me kuotat qe secili posedon, prezumohen interesa kompensuese jo te frytshme.

Per rimbursimin e tyre vlejne dispozitat e percaktuara ne nenin 2467 te kodit civil.

Neni 10. – Pjesemarrjet.

Pjesemarrja e ortakeve eshte proporcionale sipas kontributeve te kryera nga secili.

Edhe te drejtat e shoqerise u takojne ortakeve si rregull ne masen proporcionale te kuotave qe posedojne.

Mbetet pervec mundesise qe, me ndryshimin e aktit te themelimit dhe pa paragjykuar te drejten e doreheqjes per ortaket disident, u atribohen secilit prej tyre pjesemarrje ne masen jo proporcionale te kontributeve, ose te drejta te veçanta qe i perkasin administrimit te shoqerise ose kuotave te ndryshme ne shperndarjen e fitimit.

Keto te drejta jane ngushtesisht te lidhura me personin ortak e per me teper jo te transferueshme as ndermjet te gjalleve e as per shkak te vdekjes dhe mund te ndryshohen vetem me vendim unanim te marre nga ortaket te mbledhur ne asamble.

Ne rast bashkepronies te kuotave, te drejtat e lidhura me te shkojne te ushtrohen nga nje perfaqesues i perbashket neni 1105 e 1106 te kodit civil.

Ne rast pengu, uzufukti ose sekuestroje te kuotave vlejne dispozitat e percaktuara ne nenin 2352 te kodit civil.

Neni 11 – Trasferimi i kuotave

kuotat jane te ndashme dhe te transferueshme, si me akt ndermjet te gjalleve si dhe per shkak te vdekjes, me kufizimet e permendura me poshte.

Kufizimet e transferimit nder te gjalle:

Klauzola e parablerjes:

ne rast transferimi me akt ndermjet te gjalleve te kuotave dhe/ose te drejtave opsionale, ortakeve u takon e drejta e parablerjes per blerjen.

Ortaku qe ka per qellim shitjen ose sidoqofte transferimin e plote ose te pjeseshem te kuotave te tij dhe /ose te drejtave e opsioneve qe i perkasin atij do duhet te japi njoftim te gjithe ortakeve dhe organit administrativ nepermjet letres rakomande vajtje ardhje derguar ne seline e shoqerise dhe ne vendqendrimin e secilit ortak qe rezulton ne librin e ortakeve te ndertuar vullnetarisht; njoftimi duhet te permbaje gjeneralitetet e shitesit, çmimin e kerkuar, menyren e pageses dhe kushtet e tjera te shitjes.



Ortakët destinues të njoftimeve të me sipërme mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për blerjen e kuotave dhe/ose të drejtave opsionale të cilave I referohen njoftimet me modalitetet, kushtet dhe afatet në vijim:

- a) Çdo ortak i interesuar për blerjen duhet t'i dergojë ortakut ofertues deklaratën e ushtrimit të parablerjes me leter rakomande vajtje ardhje të derguar jo përtej tridhjetë ditëve nga data e marrjes të ofertës së parablerjes;
- b) Në hipotezën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e me shumë se një ortak, kuotat dhe /ose të drejtat opsionale të ofruara, i takojnë ortakeve të interesuar në proporcion me investimin në kapitalin e poseduar nga secili ortak;
- c) Parablerja duhet të ushtrohet për çmimin e treguar nga ofertuesi; atëherë kur çmimi i kërkuar do konsiderohet i tepert nga një cilito prej ortakeve che ka shfaqur në afate dhe në formën e me sipërme vullnetin të ushtrojë parablerjen, çmimi i shitjes do të percaktohet nga një arbitër i emëruar nga Kryetari i Gjykatës së vendit ku ka selinë shoqëria, në bazë të kërkesës së palës me të zellshme. Në percaktimin e çmimit, arbitri duhet të ketë parasysh gjendjen e pasurisë së shoqërisë, të ardhurave të saj, të vlerës së rrjedhshme të mirave materiale dhe jo materiale të poseduara nga ajo, të pozicionit të saj në treg dhe të çmimit e të kushteve të ofruara nga blerësi potencial dhe të çdo rrethane tjetër dhe kushti që normalisht mbahet në konsideratë me qëllim caktimin e vlerës së investimit në shoqëri, me kujdesin e veçantë të çmimit të mundshëm të mazhorancës në rast transferimi të paketës kontrolluese të shoqërisë.
Atëherë kur çmimi i caktuar nga arbitri do rezultojë me i madh nga çmimi i ofruar nga blerësi potencial, transferimi në favor të ortakeve që kanë të drejtën e parablerjes do të vazhdojë sidoqoftë çmimi i ofruar nga blerësi potencial.
Shpenzimet e arbitrazhit janë në ngarkim për gjysem të ortakut që ka për qëllim transferimin e kuotave të veta dhe gjysma në ngarkim të atyre që ushtrojnë të drejtën e parablerjes;
- d) E drejta e parablerjes do duhet të ushtrohet për të gjitha kuotat dhe / ose të drejtat e ofertuara; në rast të ushtrimit të pjesëshëm të kesaj të drejte, kështu si në hipotezën në të cilën asnjë nga ortakët ka për qëllim të blejë kuotat dhe /ose të drejtat e ofertuara, ortakët ofertues është I lire të transferojë kuotat dhe /ose të drejtat e ofertuara blerësit të treguar në ofertë brenda një muaji nga data e marrjes së kesaj oferte nga ana e ortakeve;
- e) Në rast heqje dore nga ana e njerit prej ortakeve në ushtrimin e parablerjes, e drejta që i perket atij rritet proporcionalisht dhe automatikisht ortakeve të tjera që nuk ju kanë hequr dore shprehimisht dhe paraprakisht aktit të ushtrimit të parablerjes që u perket atyre;
- f) Në hipotezën e transferimit nder të gjallëve të kuotave dhe /ose të drejtave opsionale të kryer pa keqyrjen për sa parashtruar me sipër, blerësi nuk do ketë të drejtë të regjistrohet në librin e ortakeve të ndërtuar vullnetarisht



dhe nuk do jete i ligjtimuar ne ushtrimin e votes dhe te drejtave te tjera administrative.

Kufizimet ne transferimin e kuotave te parashikuara ne kete nen nuk aplikohen ne rast te transferimit ne favor te:

- a) Ortakeve te tjere;
- b) Te bashkeshortit te ortakut çedues
- c) Te afermeve ne vije te drejte te ortakut çedues, ne çdo shkalle.



Edhe me qellim qe te evitohen interpretime te dyshimta, saktësohet qe ne frazen “transferim me akt ndermjet te gjalleve” jane te perfshira te gjitha negociimet e tjetersimit, ne pranimin me te gjere te termit, qofte me titull detyrimi qofte me titull falas, e pra me titull puro shembull, kontratave te shitjes, dhurimit, kembimit, dhurimit ne pagese, dhenies ne shoqeri dhe te akteve ose te kontratave te transferimit te pronesise se zhveshur dhe te transferimit dhe ndertimit te te drejtave reale te gezimit duke patur per objekt investimin.

Ne te gjitha rastet ne te cilat natyra e negociimit nuk parashikon nje shperblim ose shperblimi eshte i ndryshem nga paraja, ortakët do te blejne kuotat dhe/ose te drejtat te ofruara duke i derdhur ofruesit vleren korresponduese siç eshte percaktuar nga palet me akordin e perbashket ndermjet tyre, ose, ne rast mos akordi, nga arbitri, keshtu siç eshte treguar ne kete nen.

Kufizime te transferimit per shkak te vdekjes:

Investimi eshte lirisht i transferueshem per shkak te vdekjes kur trashëgimtari ose legatari i po kesaj te jete nje ortak, bashkeshorti ose nje pasardhes ne linje te drejte te ortakut te vdekur.

Ne kete rast trashëgimtari ose legatari kane te drejten te zevendesojne ortakun e vdekur, ose te kerkojne likujdimin e investimit ne shoqeri, me ane te rakomandates vajtje ardhje;

likujdimi i mundshem do te kryhet me modalitetet e parashikuara ne nenin 2289 te kodit civil.

Kur trashëgimtari ose legatari i kuotave nuk eshte ortak, bashkeshort ose pasardhes ne linje direkte te te vdekurit, transferimi i kuotave per shkak te vdekjes, si me titull te veçante si universal, eshte i percaktuar nga nenet 2284 – 2289 te kodit civil: per me teper ortakeve te mbijetuar u perket e drejta te vazhdojne shoqerine – me nje, me ose te gjithe trashëgimtarete e te vdekurit – ose te likujdoje kuotat e rena ne trashëgimi ose te shkrije shoqerine.

Neni 12- Heqja dore

Ortaku ka te drejte te heq dore nga shoqeria ne rastet e parshikuara nga ligji dhe statuti.

Ne veçanti kjo e drejte konkuron:



- Ortakut qe nuk ka miratuar ndryshimet e objektit ose te tipit te shoqerise, te bashkimit apo ndarjes se saj, transferimit te selise jashte shteti, revokimin e gjendjes se likujdimit, shtyrjen e afatit te kohezgjatjes;
- Ortakut qe nuk ka miratuar futjen apo eleminimin e klauzolave statutore qe kufizojne transferimin e kuotave, te nje klauzole te arbitrazhit, te nje apo disa shkaqeve te doreheqjes;
- Ortakut qe ka shprehur formalisht mohim te kryerjes se veprimeve qe sjellin ndryshime thelbesore te objektit te shoqerise ose nje ndryshim te rendesishem te te drejtave te atribuara ortakeve, dhe nje ndryshim te kriterave per percaktimin e vleres se kuotave;
- Te gjitha ortakeve kur ne statut jane te pranishme klauzolat qe ndalojne transferimin e kuotave ose te varur nga pelqimi i organeve te shoqerise, ortakeve ose te treteve pa parashikuar kufizime duke vlefesuar percaktimet e nenit 2469 te kodit civil.



Ne çdo rast, ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria në çdo moment nepermjet deklaratës së shkruar të dorëzuar ortakëve të tjerë dhe nga këta të pranuar me shkrim.

E drejta e heqjes dorë mund të ushtrohet nga ortakët vetëm me referim të të gjitha kuotave që posedon.

Ortakët që ka për qëllim të ushtrojnë këtë të drejtë duhet të japin njoftim organit administrativ nepermjet dergimit të letres rekomanduese brenda pesëmbëdhjetë ditëve pasuese nga data e regjistrimit në regjistrin e biznesit të vendimit që e ligjitimon atë, me tregimin e gjeneraliteteve, të vendqendrimit për njoftimet lidhur me procedimin dhe motivacionin që e ligjitimon atë.

Ku heqja dorë arrijnë të verifikojnë një fakt të ndryshëm nga një vendim që sjell regjistrimin në regjistrin e biznesit dhe përveç rasteve të cilin deklarata e heqjes dorë është pranuar me shkrim nga ortakët e tjerë, e drejta është ushtruar nepermjet letres rekomanduese të dërguar brenda tridhjetë ditëve pasuese nga data e njohjes së faktit nga ana e ortakut.

Jane të perjashtuara afate të ndryshme të parashikuara nga dispozitat e ligjit për raste të veçanta të cilat, për shembull, afati prej nëntëdhjetë ditësh i parashikuar në rast të futjes ose të anulimit të një klauzole arbitrazhi.

Investimet për të cilat ushtrohet e drejta e heqjes dorë nuk mund të scite.

Ortakët që heqin dorë nga shoqëria kanë të drejtë të marrin likuidacion të shumës që i korrespondon vlerës së investimit të poseduar me aplikimin e kriterave të vlerësimit të parashikuara në nenin pararendës 11 të këtij statuti.

Organi administrativ, me marrjen e deklaratës së heqjes dorë, jep njoftimin nepermjet rekomandësë me njoftim të marrjes nga ortakët e tjerë, duke i ftuar të gjejnë, në afatin e tridhjetë ditëve nga marrja e njoftimit, një akord mbi



modalitetet e blerjes se kuotes se ortakut qe ka per qellim te heq dore, mbi entitetin e vleres se likujdimit dhe mbi modalitetet e pageses.

Kur te githe ortaket e tjere gjejne akordin dhe kjo rezulton nga nje konvencion posacerisht i shkruar dhe i nenshkruar nga te interesuarit, blerja ne fjale mund te vije jo vetem ne proporcion te kuotave te secilit qe posedon, por dhe nga kuota te ndryshme dhe nga ana vetem e disa ortakeve dhe /ose te treteve.

Ku brenda afatit te me siperm nuk rezulton e dokumentuar me shkrim arritja e nje akordi ndermjet ortakeve dhe shoqeria nuk arrin ne heren e saj te gjeje nje akord me ortakun qe heq dore mbi caktimin e vleres se likujdimit , shoqeria dhe ortakut qe heq dore duhet t'u drejtohen nje arbitri te emeruar, mbi kerkesen e pales me te zellshme, nga Kryetari i Gjykates aty ku ka seline shoqeria qe do te siguroje vleresimin e vleres, me shpenzime te dy paleve.

Pagesa e shumes korresponduese te vleres se kuotave per te cilen eshte ushtruar e drejta e heqjes dore, duhet si rregull te kryhet brenda njeqind e tetedhjetete diteve pasuese nga data e njoftimit qe arbitri duhet t'u beje paleve, fakt i perjashtuar eventualisht nga akord i ndryshem ndermjet paleve.

Nese pagesa nuk behet nepermjet blerjes se kuotave por me perdorimin e rezervave te disponueshme ose, ne mungese, me reduktimin e kapitalit te shoqerise, kuotat e ortakut qe heq dore kontribuon ne rritjen e investimit te ortakeve te mbetur ne proporcion te entitetit te secilit prej tyre qe posedojne.

Ne kete rast nese shuma te rezervave dhe te kapitalit te shoqerise rezulton te jete jo e mjaftueshme per te kryer likujdimin e pjeses se ortakut qe heq dore, shoqeria duhet te vihet ne likujdim.

Heqja dore nuk mund te ushtrohet dhe, nese tashme eshte e ushtruar, eshte e privuar nga efektshmeria nese, para mbarimit te afatit per rimbursim, shoqeria revokon aktin ose vendimin qe e ligjitimon ate ose vendos shkrirjen e saj.

Ortakut qe ka per qellim te heq dore, nuk mund te revokojte deklaraten e bere dhe te njoftuar shoqerise nese jo me konsensusin unanim te ortakeve te mbetur te rezultuar nga vendimi i posqeshem i asamblese.

Neni 13. – Perjashtimi i ortakut.

Perjashtimi i ortakut ka vend ne rastet kur ne te cilat verifikohe se:

- Ortaku qe si nje kontribut mori detyrimin per te ofruar nje sherbim pune dhe/ose sherbimi ne favor te shoqerise, nuk eshte me ne gjendje te permbushe detyrimin e marre;
- Ortaku nuk ka aftesine per te vepruar, i deshtuar ose i denuar, me vendim te formes se prere, nje denim qe sjell ndalim.



Perjashtimi duhet te miratohet nga ortaket me vendim posaçerisht te asamblese ne te cilen mund te nderhyje ortaku per te cilin shqyrtohet perjashtimi, por pa te drejte vote.

Vendimi duhet t'i njoftohet ortakut me rakomande vajtje ardhje dhe ne rast te miratimit perjashtimi ka efekt pas tridhjete ditesh nga data e marrjes se njoftimit.

Brenda afatit te treguar ortaku mund te aktivizojë kolegjin e albitrazhit ku pas nenit 31 te ketij statuti me qellim qe te prononcohet ne themel te perjashtimit.

Ortaku i perjashtuar ka te drejte likujdimi te pjeses qe posedon me te njejtat modalitete te parashikuara per ortakun qe heq dore tek neni 12 i ketij statuti.

Neni 14 – Vendimet e ortakeve.

Vendimet e ortakeve jane ne çdo rast te marra me metoden e asamblese.

Çdo ortak qe rezulton i regjistruar rregullisht ne librin e ortakeve te ndertuar vullnetarisht dhe te cilit i perket e drejta e votes, ka titullin per te marre pjese ne asamble dhe vota e tij vlen ne masen proporcionale te pjeses qe posedon.

Nuk mund te marrin pjese ne asamble ortaket qe rezultojne ne vonese ne kuptim te nenit 2466 te kodit civil ose rezultojne titullare te pjeseve per te cilat normat e ligjit disponojne pezullimin e se drejtes se votes.

Neni 15 – Asamblete – Thirrja dhe nderhyrja.

Asamblete jane te thirrura nga organi administrativ ne seline e shoqerise ose ne nje seli tjetër, qe te jete ne Itali ose ne shtet anetar I Bashkimit European, me leter rakomande, edhe doravisht, te derguar ortakeve ne vendqendrimin qe rezulton ne librin e ortakeve te ndertuar vullnetarisht, te pakten tete dite para te asaj te caktuar per takimin.

Ne leter duhet te jene te treguara vendi, data dhe ora e takimit dhe lista e lendeve qe do shqyrtohen.

Ne te njejten leter mund te tregohen vendi, nje date tjetër dhe ora per thirrjen e takimit te dyte, atehere kur ne thirrjen e pare nuk jane arritur mazhorancat e kerkuara nga pasuesi neni 17 te ketij statuti.

Çdo ortak mund te perfaqesohet ne asamble sipas rregullave te percaktuara ne nenin 2479 te kodit civil.

Ne mungese te rregullave te thirrjes, asambleja kuptohet rregullisht e perbere per sa merr pjese i gjithe kapitali shoqerise e te gjithe administratoret dhe kontrolloret jane te pranishem ose te informuar per mbledhjen e asnjeri nuk kundershton shqyrtimit te argumentave te rendit te dites.

Neni 16 – Asamblete – Kryesija



Asambleja eshte e udhehequr nga Administratori i vetem, nga Kryetari i Keshillit te Administrimit (ne rast te emerimit te Keshillit te Administrimit), ose nga Administratori me i vjeter ne moshe (ne rast te emerimit te me shume administratoreve me tagra te ndare ose te bashkuar), ose, ne rast te mungeses se tyre ose te mospermbushjes, nga personi i zgjedhur nga nderhyresit.

Kryetari eshte i asistuar nga nje sekretar e emeruar, edhe nga jo ortakët, nga asambleja.

Ne asamblete qe sjellin ndryshime ketij statuti Kryetari eshte i asistuar nga nje Noter.

Neni 17 – Asamblete – Kuorumi formues dhe vendim marres.

Asambleja vendos ne thirrjen e pare me vote favorizuese te shume ortakeve qe perfaqesojne te pakten 2/3 (dy te tretat) te kapitalit te shoqerise, ndersa ne thirrjen e dyte do te jete e mjaftueshme vota favorizuese e shume ortakeve qe perfaqesojne mazhorancen e kapitalit te shoqerise.

Per vendimet qe i perkasin ndryshimeve te ketij statuti, ose vendimeve qe i perkasin kryerjes se veprimeve qe sjellin ndryshime thelbesore te objektit te shoqerise ose nje ndryshim i rendesishem te drejtave te ortakeve, asambleja vendos gjithmone me vote favorizuese te shume ortakeve qe perfaqesojne te pakten dy te tretat e kapitalit te shoqerise.

Jane te perjashtuara eventualisht dispozitat e tjera te ketij statuti qe parashikojne mazhoranca specifike.

Neni 18- Asamblete – Votimi dhe verbalizimi i vendimeve

Vendimet jane marre me ngritjen e dores ose, nese eshte kerkuar, me apel nominal.

Ne çdo rast vota duhet te jete e qarte dhe e tille qe te lejoje identifikimin e ortakeve qe kane abstenuar dhe mospajtues.


Vendimet e marra nga asambleja duhet te rezultojne nga proces verbali te nenshkruar nga Kryetari i stance dhe nga sekretari ose nga Noteri nese eshte detyrim ligjor.

Nga ata duhet te rezultojne ne veçanti identiteti i pjesemarrësve dhe kapitali e secilit perfaqesues, rezultati i votimit dhe, me kerkese te ortakut, deklaratat e mundshme te bera ne lidhje me argomentin e rendit te dites.

Neni 19 – Administrata.

Shoqeria mund te administrohet, alternativisht, mbi vendimin e ortakeve ne momentin e emerimit:

a) Nga nje administrator i vetem;



- b) Nga keshilli i administrimit i perbere nga dy ne pese administrator, sipas numerit te percaktuar nga ortaket ne momentin e emerimit;
- c) Nga dy ose me shume administratore me tagra te bashkuar, veçmas ose te ushtruar me mazhorance.

Per organin administrativ kuptohet administratori i vetem, ose keshilli i administrimit, ose administratoret bashkerisht te cileve u eshte besuar bashkerisht ose veçmas administrimi.

Administratoret mund te jene edhe jo ortake.

Nuk u aplikohet administratoreve ndalimi I konkorrnces ne pajtim me nenin 2390 kodit civil.

Neni 20 – kohezgjatja e detyres, revokimi, pushimi.

Administratoret mbeten ne detyre deri ne revokimin ose doreheqjen ose per periudhen e caktuar nga ortaket ne momentin e emerimit.

Administratoret jane te rizgjedhur.

Pushimi i administratoreve per mbarim te afatit ka efekt nga momenti ne te cilin organi i ri administrativ eshte rithemeluar.

Neni 21 – Keshilli i Administrimit

Keshilli i Administrimit zgjedh midis anetareve te tij Kryetarin, kur per kete nuk kane vendosur ortaket ne aktin e emerimit te administratoreve; mundet nder te tjera te emeroje nje ose me shume zv. Kryetar, te cileve u atribohet tagrat e zevendesimit te Kryetarit ne rastet e mungeses se tij ose te ndalimit, dhe nje sekretar.

Keshilli i Administrimit mblidhet ne seline e shoqerise ose ne nje seli tjeter, qe te jete ne Itali ose ne nje Shtet anetar i Bashkimit European, te gjitha heret qe Kryetari e çmon te nevojshme ose kur eshte bere kerkese me shkrim prej tyre te pakten dy te anetareve te saj ose nga kolegji kontrollues ose nga revizori i llogarive, nese emerohen.

Thirrja behet nga Kryetari me njoftim, te derguar secilit anetar te keshillit dhe te kolegjit kontrollues ose revizorit, nese emerohen, me rakomande vajtje ardhje, ose me çfare do menyre tjeter te pershtatshme qe te siguroje proven e marrjes se njoftimit, te pakten tre dite para takimit dhe, ne rast urgjence, te pakten nje dite para. Ne njoftim vendosen te fiksuara data, vendi dhe ora e mbledhjes, dhe rendi i dites.

Do çmohet sidoqofte vlefshmerisht i perbere Keshilli i Administrimit, edhe me difekt formal te thirrjes, kur jane te pranishem te gjithe administratoret dhe qe jane te pranishem ose te informuar per mbledhjen te gjithe anetaret e kolegjit kontrollues ose revizori, nese emerohen; mbetet e drejta e secilit prej te



pranishmeve te kundershtojne diskutimet e argumentave per te cilet nuk çmohen mjaftueshem informues.

Mbledhjet e Keshillit te Administrimit jane te udhehequra nga Kryetari ose, ne mungese, nga administratori i caktuar nga te pranishmit.

I perket Kryetarit te Keshillit te Administrimit :

- Te konstatoje rregullat e themelimit te tij;
- Te vertetoje identitetin dhe ligjitimimin e te pranishmeve;
- Te drejtoje dhe te rregulloje zhvillimin e mbledhjes;
- Te shpall rezultatin e votimeve;
- Te identifikoj keshilltaret favorizues, abstenues dhe /ose mospajtues;

Vendimet e keshillit duhet te konstatojne me proces verbal te nenshkruar nga Kryetari dhe nga Sekretari. Nga proces verbali (nga anekset relative) duhet te rezultojne, per vertetim te Kryetarit:


- Data e takimit;
- Perberjen e regullt te mbledhjes ;
- Identitetin e te pranishmeve;
- Rezultatin e votimit;
- Identifikimin e keshilltareve favorizues, abstenues dhe/ose mospajtues me motivimin e abstenimit ose te mospajtimit;
- Mbi kerkesen e administratoreve deklaratat e tyre perkatese ne rendin e dites.

Keshilli i administrimit eshte vlefshmerisht i perbere me pranine te mazhorances se anetareve te tij dhe vendos vlefshmerisht me vote favorizuese te mazhorances absolute te te pranishmeve. Ne rast barazimi te votave propozimi kuptohet i rrezuar. Vota nuk mund te jepet me perfaqesi. Vendimet e administratoreve duhet te transkriptohen ne librin perkates.

Keshilli i administrimit, ne kufijte e parashikuara nga neni 2381 kodi civil, mund te delegoje atributet e veta ne lenden e drejtimit teresisht ose pjeserisht nje komiteti ekzekutiv i perbere nga disa prej perberesve te vet ose nga nje ose me shume te perberesve te vet, edhe veçmas. Komiteti ekzekutiv ose administratori ose admnistratoret e deleguar, mund te kryejne te gjitha aktet e zakonshme ose te jashtezakonshme te administrimit qe do te rezultojne nga delegimi i dhene nga keshilli i administrimit, me kufizimet dhe modalitetet e percaktuara tek vet autorizimi.

Neni 22 – Administrim bashkerisht dhe veçmas.

Ne rast te emerimit te me shume administratoreve me tagra te perbashket dhe/ose te ndara, tagrat e administrimit, ne rast te emerimit, do te mund t'i atribohen po atyre si bashkerisht si veçmas, ose disa tagra te administrimit do te mund do te mund t'i atribohen veçmas dhe te tjera te perbashketa.



Neni 23 – Tagrat e organit administrativ.

Organi administrativ ka te gjitha tagrat per administrimin e shoqerise.

Ne momentin e emerimit munden megjithate te jene te treguara kufizimet e tagrave te administratoreve.

Ne rastin e Keshillit te Administrimit te formuar nga dy anetare, nese administratoret nuk jane dakord rreth revokimit te mundshem te njerit prej administratoreve te deleguar, te dy anetaret e Keshillit humbin detyren ata duhet qe brenda 15 diteve t'i nenshtrohen vendimit te ortakeve per emerimin e nje organi te ri administrativ.

Ne rastin e emerimit te me shume administratoreve, ne momentin e emerimit tagrat e administrimit mund t'i atribohen po ketyre bashkerisht, vecmas ose me mazhorance, ose disa tagra te administrimit mund t'i atribohen te ndara dhe te tjera bashkerisht. Ne mungese te çdo saktesimi ne aktin e emerimit, sipas rregullave te modaliteteve te ushtrimit te tagrave te administrimit, keto tagra kuptohen te atribuara administratoreve vecmas ndermjet tyre.

Ne rast te administrimit bashkerisht, administratoret individualisht nuk mund te kryejne asnje veprim, perjashtuar rastet ne te cilat eshte e nevojshme te veprohet me urgjence per te shmangur nje dem shoqerise.

Nese administrimi i besohet u eshte besuar vecmas me shume administratoreve, ne rast kundershimi te nje administratori per veprimin qe nje tjeter ka per qellim t'a kryejte, kompetent per te vendosur mbi kundershimin jane te gjithe administratoret.

Mund te emerohen drejtore, ndihmes ose perfaqesues per kryerjen e akteve te caktuara ose kategorive te akteve, duke percaktuar tagrat.

Neni 24. – Perfaqesimi


Administratori i vetem ka perfaqesimin e shoqerise.

Ne rastin e emerimit te Keshillit te Administrimit, perfaqesimi i shoqerise i perket Kryetarit te Keshillit te Administrimit dhe keshilltareve te deleguar individualisht, nese emerohen.

Ne rast te emerimit te me shume administratoreve, perfaqesimi i shoqerise i perket po ketyre bashkerisht ose vecmas, ne te njejten menyre ne te cilen jane atribuar ne momentin e emerimit te tagrave te administrimit.

Perfaqesimi i shoqerise i perket edhe drejtoreve, ndihmesave dhe perfaqesuesve, ne kufijte e tagrave qe atyre ju jane dhene ne aktin e emerimit.

Perfaqesimi i shoqerise ne likujdim i perket likujdatorit ose Kryetarit te Kolegjit te likujdatoreve dhe anetareve te tjere te mundshem te Kolegjit te likujdimit me modalitetet dhe kufizimet e percaktuara ne momentin e emerimit.



Neni 25 – Shperblimet e Administratoreve.

Administratoreve u perket nje rimbursim i shpenzimeve te shkaktuara per arsye te funksionit te tyre.

Ortaket mund te caktojne nder te tjera administratoreve nje shperblim vjetor ne mase fikse, ose nje shperblim proporcional per fitime neto te ushtrimit, dhe te caktoje nje shperblim per pushimin nga detyra dhe te vendosi nje llogari per fondin e daljes ne pension me modalitetet e percaktuara me vendim te ortakeve.

Ne rast te emerimit te nje Komiteti Ekzekutiv ose te Keshilltareve te deleguar, shperblimi i tyre eshte percaktuar nga Keshilli i Administrimit ne momentin e emerimit.

Referuar nenit 11, paragrafi 6, D.Lgs. 18 dhjetor 1997, nr. 472, shoqeria merr persiper vet, edhe ndaj administrates publike ose enteve qe administrojne taksat, debine per sanksione si pasoje e shkeljeve qe perfaqesuesit e shoqerise kryejne ne kryerjen e detyrave te tyre ne kufijte e tagrave te tyre.

Marrja persiper vlen ne rastet ne te cilat perfaqesuesi ka kryer shkelje pa dashje dhe eshte çdo rast i perjashtuar kur kush ka kryer shkelje dhe ka vepruar me vullnet ne dem te shoqerise.

Eshte gjithashtu e perjashtuar ne rastet kur faji ka ato tipare veçanerisht te renda te percaktuara nga neni 5, paragrafi 3, D.Lgs. nr. 472/1997.

Faji veçanerisht i rende kuptohet i provuar kur gjyqetaret e taksave, te investuar ne mosmarreshjen, do te pronuncohen ne kuptimin analog ose kur njihen nga vete autori i shkeljes qe provat e sjella nga zyra ose enti verifikues jane te tilla qe e bejne te dukshme dhe te padiskutueshme mosrespektimin makroskopik te elementeve tatimor te detyrueshem.

Nuk eshte e lejueshme heqja dore ose transaksioni nga ana e shoqerise per veprimin e pergjegjesise kunder administratoreve.

Neni 26 – Organi i Kontrollit.

Ne rastin kur per dispozita te ligjit neqoftese eshte e nevojshme, kontrolli i shoqerise eshte besuar nje Kolegji kontrolli i perbere dhe funksionues siç eshte percaktuar nga neni 2397 e vijues i kodit civil.

Kolegji ka detyrimet dhe tagrat sipas neneve 2403 dhe 2403 bis te kodit civil dhe ushtron gjithashtu kontrollin kontabel.

Kontrolloret qendrojne ne detyre nje trevjeçar dhe jane te rizgjedhshem.

Asambleja qe emeron kontrolloret percakton shperblimin e tyre qe i perket, sipas dispozitave te lendes.

Neni 27. – Kontrolli i Ortakeve.



Ne çdo rast ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin kanë të drejtë të kënaqen nga informacione nga administratorët mbi zhvillimin e punëve të shoqërisë dhe të konsultojnë, edhe nëpërmjet profesionistëve të tyre të besueshëm, librat e shoqërisë dhe dokumentat relativ të administrimit.

Neni 28 – ushtrimi i shoqërisë dhe bilanci.

Ushtrimet e shoqërisë mbyllet me 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Organi administrativ merr masa, brenda afatëve dhe nën vëzhgimin e dispozitave të ligjit, në plotësimin e bilancit dhe të shënimit integre, duke i bashkëlidhur, ku është e detyrueshme, me relacionin mbi ecurinë e drejtimit të shoqërisë.

Kur e kërkojnë nevojat e posaçme, asambleja që miraton bilancin do të mund të thirrret edhe në një afat më të gjatë prej njëqind e tetëdhjetë ditësh nga mbyllja e ushtrimit me respektin për sa është përcaktuar nga paragrafi 2 i nenit 2364 i kodit civil.

Neni 29 – Fitime dhe Humbje

Nga fitimet të rezultuara nga bilanci i ushtrimit duhet të zbritet një shumë që i korrespondon 5% (pese përqind) për t'ju caktuar rezerva ligjore deri që kjo të mos ketë arritur një entitet të barabartë me një të pestën e kapitalit të shoqërisë.

Mbi destinacionin të fitimeve të mbetura vendos asambleja e ortakëve që miraton bilancin.

Mund të shpërndahen dividendet vetëm në lidhje me fitimet realisht të fituara dhe, nëse verifikohet një humbje e kapitalit të shoqërisë, nuk mund të shpërndahen fitimet nëse nuk është proceduar me pas në riintegrimin ose zvogelimin e saj në masën korresponduese.

Nuk është e lejuar shpërndarja e llogarive mbi dividendet.


Neni 30 – Shkërkimi dhe likuidimi

Duke arritur për çdo shkak dhe kohë në shkërkimin e shoqërisë, asambleja e ortakëve, me votë favorizuese të shumë ortakëve që përfaqësojnë me shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, do të përcaktojë modalitetet e likuidimit dhe do emerojë një ose më shumë likuidatorë duke i caktuar tagrat, në përputhje me normat e pa ndryshueshme të ligjit.

Shoqëria mund të revokojë gjendjen e likuidimit me të njëjtat mazhoranca të parashikuara në paragrafin pararendës, por në këto rast i përket ortakut mospajtues të drejta e heqjes dore.

Neni 31. – Klauzola e arbitrazhit.

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë që ka për objekt të drejta relative të disponueshme në raportin e



shoqerise, me perjashtim te atyre ne te cilat ligji parashikon nderhyrjen e detyrueshme te Prokurorise, do duhet te zgjidhet nga nje arbitër te emeruar nga Kryetari te Gjykates se vendit ku ka seline shoqeria.

Selia e arbitrazhit do jete prane vendqendrimit te arbitrit.

Arbitri do duhet te vendosi, sipas se drejtes, brenda nentehjete diteve nga dita e emerimit.

Mbetet deri tani e percaktuar ne menyre te pa revokueshme qe zgjidhjet dhe percaktimet e arbitrit do kushtezojne palet.

Arbitri do percaktoje ndarjen e shpenzimeve te arbitrazhit ndermjet paleve.

Çdo ndryshim qe i perket kesaj klauzole duhet te jete e miratuar nga ortaket qe perfaqesojne te pakten dy te tretat e kapitalit shoqeror. Ortaket qe mungojne ose mospajtues mund, brenda 90 (nentehjete) diteve pasuese, te ushtrojne te drejten e heqjes dore.

Per sa nuk eshte parashikuar, zbatohen dispozitat e dekretit legjislativ 17 janar 2003, nr. 5 dhe ndryshimet vijuese dhe integrimet.

Neni 32 – Dispozitat e referimit.

Per sa nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, i referohet dispozitave te permbajtura ne kodin civil dhe ne ligjet e veçanta ne fushen e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

De Cian Paolo, Michele Palumbo Noter.

Nr. 41834 Rep.

Vertetoj une i nenshkruari Doktor Michele Palumbo, Noter ne Sedico, i regjistruar ne Kolegjin e Rrethit te Notereve ne Belluno, qe ky dokument eshte konform dokumentit origjinal qe gjendet bashkelidhur nen germen "A" te aktit te marre nga une noteri me date kater nentor 2009, nr. 25960 rep., n. 6461 kol, regjistruar ne Belluno me date njembedhjete nentor 2009 me nr. 787 seria IT.

Perbehet prej tete fletesh dhe nje gjysem flete.

Sedico, via Nigassa nr. 2/A, njembedhjete prill 2018.

Firma vula

Apostile

Konventa e Hages 5 tetor 1961

1) Shteti: Republika Italiane



- 2) Ky akt publik eshte nenshkrur nga Michele Palumbo
- 3) Agjent ne cilesine e Noterit
- 4) Dhe i shenuar me vule te Michele Palumbo Di Carmelo Notaio ne Sedico Vertetuar
- 5) Ne Belluno 6) me 12/04/2018
- 7) nga Prokurori i Republikes ne Belluno
- 8) nen numerin 177/2018 regj. Apos.
- 9) Vula 10) firma

Funksionari i Ngarkuar

Prokurori i Republikes

Dr. Paola Luca

Firma



Deklarohet qe ky perkthim eshte realizuar konform tekstit origjinal ne gjuhen italiane nen kujdesin e perkthyesit zyrtar

PLARENT ANAMALI

I autorizuar nga Ministria e Drejtësisë



Republika e Shqipërisë
Ministria e Drejtësisë
Dhoma e Noterisë Shkodër

№. reg. 1658

Vërtetim Përkthimi



Sot me 08 maj 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje Arben Salim Kopliku, noter, anëtar i Dhomës së Noterisë Shkodër, me seli në Bulevardin "Zog I", pall.1, u paraqit personalisht:

1. Përkthyesi Zyrtar i Gjuhës Italiane, Z. Plarent Anamali, i njohur prej meje si i tillë, dtl. 11 Prill 1977, lindur në Shkodër, banues në Shkodër, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. vetjak H70411128E, i cili deklaroi se përkthimi në gjuhën shqipe i dokumentave, bashkëlidhur këtij vërtetimi, është identik me dokumentat, në gjuhën italiane.

Arben Salim Kopliku
Noter



di acqua, luce e gas, acquedotti e fognature, movimento terra, demolizioni e rifacimenti di opere edili, cementi armati, costruzione e ristrutturazione di opere monumentali, consolidamenti e bonifiche terreni, impianti sportivi, opere ferroviarie edili e specializzate in genere, di impianti di produzione, trasporto, gestione e vendita di energia e riscaldamento prodotto da trattamento di lavorazione anche di rifiuti, sia per enti pubblici (anche militari) che privati e tutto quanto è annesso e connesso all'edilizia in genere ed a quanto più sopra specificato;

2) l'acquisto, la gestione e la vendita di beni immobili e di diritti immobiliari in genere;

3) l'utilizzo di fonti di energia e la gestione degli impianti di produzione ad esse connessi;

